



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCËVE

Maj 2019

EKONOMIA DHE BUXHETI

Raport Mujor

Qershor

Korrik

Gusht

Shtator

Tetor

Nentor

Dhjetor

# EKONOMIA DHE BUXHETI

Raport Mujor

Maj 2019

© Ministria e Financave dhe Ekonomisë, 2019  
Drejtoria e Makroekonomisë dhe Statistikave  
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 3, Tiranë

[www.financa.gov.al](http://www.financa.gov.al)

# Përmbajtja

<b>VEÇORITË KRYESORE</b>	<b>2</b>
<b>ZHVILLIMET EKONOMIKE</b>	<b>3</b>
1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit	3
2. Kursi Mesatar i Këmbimit	4
3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave	5
4. Bilanci i Pagesave	6
5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar	7
6. Kredia për Ekonominë	8
7. Oferta e Parasë	9
8. Depozitat sipas Burimeve	10
<b>SEKTORI FISKAL</b>	<b>11</b>
1. Buxheti i Konsoliduar	11
2. Të Ardhurat sipas Burimeve	12
3. Financimi i Bilancit Fiskal	12
<b>ANEKSI STATISTIKOR</b>	<b>13</b>

# Veçoritë Kryesore

- *Indeksi i çmimeve të konsumit* në muajin Maj 2019 arriti në 106.5 për qind;
- *Norma vjetore e inflacionit* për muajin Maj 2019 ishte 1.5 për qind;
- *Kursi mesatar i këmbimit të monedhës vendase me dy monedhat kryesore të huaja* për muajin Maj 2019 ishte 109.96 lekë për dollarë dhe 122.99 lekë për euro;
- *Normat e interesit të depozitave në lekë* gjatë muajit Maj 2019 shënuan kuotën 0.43 për qind për ato 12 –mujore; 0.42 për qind për depozitat 6-mujore; 0.19 për qind për depozitat 3-mujore dhe 0.53 për qind për depozitat 1-mujore;
- *Normat e interesit për huatë në lekë* ishin 6.55 për qind për huatë 12-mujore dhe 9.67 për qind për ato 6-mujore;
- *Oferta totale e parasë, e matur nga agregati M3*, arriti në rreth 1.268.366 milionë lekë në muajin Maj, duke shënuar një rritje prej rreth 3.7 për qind, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- *Bilanci i përgjithshëm i pagesave* për tremujorin e parë të 2019-ës shënoi rënie të mjeteve valutore (rezervës), duke shënuar vlerën -70.7 milionë euro.
- *Situata Buxhetore për periudhën Janar-Maj 2019 rezultoi me një sufiçit të përgjithshëm prej rreth 0.4 miliardë lekë, ndërkohë që ishte planifikuar një defiçit prej 3.5 miliardë lekë.*
- *Të ardhurat gjithsej të realizuara gjatë periudhës Janar- Maj 2019, arritën në rreth 188.464 miliardë lekë ose afërsisht 99.5% e planit për këtë periudhë.*
- *Shpenzimet gjithsej gjatë të njëjtës periudhë, arritën në rreth 188.063 miliardë lekë ose 97.6% e shpenzimeve të planifikuara për këtë periudhë.*


# Zhvillimet Ekonomike

## 1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Inflacioni vjetor për muajin Maj 2019 ishte +1.5%. Ndërsa, një vit më parë ndryshimi vjetor i indeksit të çmimeve të konsumit ishte +2.1%. Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK) për muajin Maj 2019 shënoi rënie prej 1.0 për qind krahasuar me muajin paraardhës, gjithashtu në muajt Mars dhe Prill 2019 pësoi rënie prej 0.3 dhe 0.2 për qind respektivisht, në krahasim me muajin parardhës përkatës. Përsa i përket një viti më parë, Indeksi i Çmimeve të Konsumit për muajin Maj 2018 shënoi rënie prej 1.2 për qind në krahasim me muajin paraardhës.

Krahasuar me muajin Maj 2018, rritja më e madhe e çmimeve vërehet në grupin “Ushqime dhe pije joalkoolike” me 3.1%, pasuar nga grupet “Pije alkoolike dhe duhan” me 1.4%, “Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji” dhe “Hotele, kafene dhe restorante” me 1.1% secili, “Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë” dhe “Shërbimi arsimor” me 0.7 %, secili, “Veshje dhe këpucë” me 0.5% etj.

Nga tërësia e mallrave dhe shërbimeve që përbëjnë shportën e konsumit, çmimet e grupit



“Argëtim dhe kulturë” u ulën me 0.6 %, pasuar nga grupet “Shëndeti” dhe “Transporti” respektivisht me 0.5% dhe 0.1%.

**Ndryshimi mujor i indeksit është -1.0%.** Krahasuar me muajin Prill 2019, çmimet e grupit “Ushqime dhe pije joalkoolike” u ulën me 2.6%, pasuar nga grupet “Veshje dhe këpucë” me 0.6%, “Mallra dhe shërbime të ndryshme” me 0.2 % etj. Ndërsa, çmimet e grupit “Argëtim dhe kulturë” u rritën me 0.7%, pasuar nga grupi “Pije alkoolike dhe duhan” me 0.1%.

**Tab - 1** Ndryshimi vjetor i Indeksit të Çmimeve të Konsumit (në %)

VITI	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
<b>2018</b>	1.7	2.1	2.0	2.1	<b>2.1</b>	2.4	2.3	2.2	2.1	1.9	1.8	1.8
<b>2019</b>	1.9	1.7	1.1	1.4	<b>1.5</b>							

Burimi: INSTAT


## 2. Kursi mesatar i këmbimit

Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt euros në muajin Maj 2019, arriti në 122.99 lekë/euro, duke shënuar rënie në vlerë me 1.08 për qind krahasuar me një muaj më parë. Në fund të muajit Maj, një euro u këmbye me 122.63 lekë.

Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt dollarit amerikan në muajin Maj 2019 arriti në 109.96 lekë/dollarë duke shënuar rënie në vlerë me 0.56 për qind kundrejt muajit Prill 2019. Në fund të muajit Maj, kursi i këmbimit për dollarin amerikan arriti në nivelin 109.96 lekë/dollarë.

Në krahasim me muajin Maj të vitit të kaluar, rezulton se monedha shqiptare është mbiçmuar (mesatarisht) ndaj monedhës evropiane në masën 3.15 për qind, ndërsa kundrejt dollarit amerikan rezulton se është nënçmuar në masën 2.36 për qind. Forcimi i lekut në dy vitet e fundit është nxitur nga përshpejtimi relativ i rritjes ekonomike në vend, pritjet për vazhdimin e kësaj tendence në të ardhmen dhe reduktimi i primit të rrezikut për ekonominë tonë.

Fig-2



**Ecuria e Kursit të Këmbimit gjatë muajit Maj 2019**

Burimi: Banka e Shqipërisë

Kursi i këmbimit të euros me dollarin amerikan, pësoi një rritje mesatare rreth 0.89 dollarë/euro. Ndër faktorët e brendshëm që kanë ndikuar në ecurinë e monedhës vendase gjatë këtij muaji përmendim: ruajtja e ritmeve pozitive të rritjes ekonomike në vend, efikasiteti i politikës fiskale, efikasitet në politikën monetare dhe në operacionet ndërbankare të ndërmarra nga Banka e Shqipërisë, etj.

### 3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave

Gjatë muajit Maj 2019, normat e interesit të depozitave me afat 1 mujore dhe 12 mujore shënuan vlerat më të larta prej 0.53 dhe 0.43 për qind, pasuar nga ato me afat 6 dhe 3 mujore që arritën përkatësisht kuotën 0.42 dhe 0.19 për qind.


Normat e interesit të depozitave 6, 1 dhe 12 mujore kanë pësuar rënie mujore prej përkatësisht 0.10, 0.09 dhe 0.05 pikë përqindje, ndërsa normat e interesit të depozitave 3 mujore kanë shënuar rritje me 0.01 pikë përqindje.

Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, të gjitha normat e interesit të depozitave me afat maturimi 12, 6, 3 dhe 1 mujore, kanë pësuar rënie vjetore prej përkatësisht 0.32, 0.14, 0.08 dhe 0.11 pikë përqindje.

Normat e Interesit të huave 6 dhe 12 mujore gjatë muajit Maj 2019 arritën përkatësisht kuotën prej 9.67 dhe 6.55 për qind. Në krahasim me një muaj më parë, normat e interesit të huave 12 mujore kanë shënuar rritje mujore prej 0.32 pikë përqindje, gjithashtu normat e interesit 6 mujore kanë shënuar rritje mujore me 2.8 pikë përqindje. Duke krahasuar me një vit më parë normat e interesit të huave 6 dhe 12 mujore kanë shënuar rritje vjetore prej përkatësisht 3.09 dhe 0.69 pikë përqindje.

Normat e interesit të bonove të thesarit 12 mujore gjatë muajit Maj 2019 arritën nivelin 1.29 për qind duke shënuar kështu rritje mujore prej 0.18 për qind dhe rënie vjetore prej 0.97 për qind.


Fig. 3



**Normat e interesit për depozitat (%)**

Burimi: Banka e Shqipërisë

Fig-4




**Normat e interesit për huatë dhe bonot**

Burimi: Banka e Shqipërisë

## 4. Bilanci i Pagesave

Bilanci i përgjithshëm i pagesave për tremujorin e parë të vitit 2019 pësoi rënie të mjetëve valutore, me rreth 70.7 milionë euro. Tremujori i parë i 2019-ës u mbyll me një deficit të llogarisë korrente prej rreth 243 milionë euro, dhe vlerësohet në rritje në terma vjetore me rreth 41%. Deficiti tregtar u zgjerua me rreth 13%, në nivelin 406 milionë euro. Shkalla e ekspozimit të ekonomisë shqiptare vlerësohet në 226 milionë euro në rritje me 72 milionë euro krahasuar me një vit më parë. Fluksi hyrës neto në llogarinë financiare (pa përfshirë mjetet e rezervës) shënon 289 milionë euro dhe mbulon plotësisht deficitin korrent. Karakteristika strukturore e Bilancit të Pagesave paraqitet në figurën 5.

Fig-5




**Bilanci i Pagesave per T1 - 2019**

Burimi: Banka e Shqipërisë

Gjatë periudhës transaksionet në llogarinë korrente vlerësohen rreth 2,610 milionë euro dhe janë zgjeruar me 7% në terma vjetorë. Deficiti i llogarisë korrente shënon 243 milionë euro, në rritje vjetore me rreth 41%. Ecuria e deficitit korrent në këtë tremujor, reflekton zgjerimin e deficitit tregtar të mallrave dhe balancës negative të të ardhurave parësore, pasojë e ecurisë në rritje të riatdhësimit të fitimeve dhe dividendëve. Kompozicioni i deficitit të llogarisë korrente shprehet sipas elementeve kryesorë përbërës (në terma neto) për tremujorin e parë 2019 (Fig-6):

Fig-6



**Llogaria Korente per T1 - 2019**

Burimi: Banka e Shqipërisë

- (i) bilanci tregtar me -243.3 milionë euro,
- (ii) shërbime neto me 288.8 milionë euro,
- (iii) të ardhura neto me -28.9 milionë euro,
- (iv) transferta neto me 191.2 milionë euro.




## 5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar

Gjatë muajit Maj 2019, sistemi bankar ka shënuar rritje të mjeteve valutore neto (M.V.N), me rreth 38.926 milionë lekë krahasuar me muajin Maj të vitit 2018. Kjo rritje ka ardhur kryesisht si pasojë e rritjes së mjeteve valutore neto bankës qendrore me rreth 54.950 milionë lekë.

Krahasuar me një muaj më parë mjetet valutore neto kanë shënuar rënie me 7.328 milionë lekë, ku më së shumti ka kontribuar rënia mujore prej 8.265 milionë lekë e bankës paradepozituese.

Fig-7




**Ecuria e M.V.N. të sistemit në Maj' 18 - Maj '19**

Burimi: Banka e Shqipërisë

Oferta totale e parasë, e matur nga agregati M3, arriti në 1.268.366 milionë lekë në muajin Maj 2019, duke shënuar rritje prej rreth 45.356 milionë lekë krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, pra një rritje vjetore prej 3.7 për qind.

Në muajin Maj 2019, sistemi bankar rezulton me rënie mujore prej 3.365 milionë lekë ose -0.3 për qind në mjetet valutore neto krahasuar me muajin paraardhës.

Fig-8




**Agregati M3 Maj '18 - Maj '19**

Burimi: Banka e Shqipërisë

## 6. Kredia për Ekonominë

Totali i kredisë për ekonominë për muajin Maj 2019 arriti në rreth 548.922 milionë lekë. Bilanci i kredisë, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, shënoi rritje me vlerë 9.379 milionë lekë, ose rritje me rreth 1.74 për qind. Struktura e kredisë sipas monedhave është e balancuar mes monedhës kombëtare (50.2%) dhe monedhve të huaja (49.8%).

Fig-9




**Rritja e stokut total të kredive**

Burimi: Banka e Shqipërisë

Gjatë muajit Maj 2019, zëri “Korporata të tjera jo-financiare”, zuri peshën më të lartë të kredive, me rreth 59.6 për qind ose 327.208 milionë lekë, ndjekur nga kreditë për individë, ku pesha e tyre specifike arriti në nivelin 34.30 për qind ose 188.256 milionë lekë. Zërat “Korporata jo financiare publike” dhe “Korporata të tjera financiare” arritën respektivisht 3.86 dhe 2.12 për qind apo 21.208 dhe 11.618 milionë lekë.

Fig-10



**Përberja e kredive Maj '19**


Burimi: Banka e Shqipërisë

Për sa i përket shpërndarjes së kredisë sipas monedhës për muajin Maj 2019, zëri “Korporata të tjera jofinanciare” zuri peshën më të lartë të kredive, me rreth 72.59 për qind, ndjekur nga “Sektorë të tjerë rezidentë” me rreth 23.77 për qind. “Korporata të tjera financiare” dhe “Korporata jofinanciare publike” kontribuojnë përkatësisht me 2.0 për qind dhe rreth 1.64 për qind.

## 7. Oferta e Parasë

Paraja jashtë Korporatave Depozituese arriti në rreth 274.191 milionë lekë në fund të muajit Maj 2019. Raporti i Parasë jashtë Bankave me M3 në Maj 2019 ka shënuar rritje mujore prej 0.14 për qind si dhe rritje vjetore prej 0.79 për qind, duke arritur nivelin 21.6 për qind. Raporti i Parasë jashtë Bankave me Depozitat ka shënuar gjithashtu rritje mujore prej 0.23 për qind dhe rritje vjetore prej 1.28 për qind, duke shënuar nivelin 27.6 për qind.

Fig-11




**Raporte të parasë jashtë bankave me M3 dhe Depozitat**

Burimi: Banka e Shqipërisë

Depozitat në valutë, si përbërësi kryesor i ofertës monetare për muajin Maj 2019, kanë shënuar rritje vjetore prej 25.211 milionë lekë, e sjellë kryesisht nga depozitat për individë, të cilat kanë përbërë rreth 80.9 për qind të depozitave në valutë. Gjithashtu depozitat në Lekë gjatë muajit Maj 2019 shënuan rritje prej 0.660 milionë lekë në krahasim me muajin Maj 2018. Sektori i Individëve në lekë ka zënë rreth 83 për qind të tyre.

Fig-12




**Raporti i Depozitave ndaj M3**

Burimi: Banka e Shqipërisë

## 8. Depozitat sipas Burimeve

Gjatë muajit Maj 2019, zëri “Sektorë të tjerë rezidentë” zuri nivelin më të lartë të depozitave të transferueshme në lekë, me rreth 83 për qind, ndjekur nga “Korporata të tjera jofinanciare”, me rreth 12.6 për qind dhe nga “Korporata jo-financiare publike” me 2.5 për qind. “Sektorë të tjerë rezidentë” dhe “Korporata të tjera jofinanciare” ishin gjithashtu burimi më i rëndësishëm i depozitave në monedhë të huaj, përkatësisht me rreth 80.9 për qind dhe rreth 16.7 për qind. “Sektorë të tjerë rezidentë” ishin dukshëm burimi më i rëndësishëm i depozitave totale me rreth 81.9 për qind e totalit.

Fig-13




Rritja e stokut total të depozitave

Burimi: Banka e Shqipërisë

Në total, “Sektorë të tjerë rezidentë” përbëjnë pjesën më të madhe me rreth 814.035 milionë lekë të depozitave totale. Ata ndiqen nga “Korporata të tjera jofinanciare” (147.225 milionë lekë), “Korporata të tjera financiare” (16.032 milionë lekë), dhe “Korporata jofinanciare publike” (15.410 milionë lekë). “Qeveria lokale” kontribuoi me rreth (1.472 milionë lekë) në totalin e depozitave.

Fig-14



Përberja e depozitave Maj 2019

Burimi: Banka e Shqipërisë

Gjatë muajit Maj 2019, niveli i përgjithshëm i depozitave arriti vlerën rreth 994.175 milionë lekë. Krahasuar me një muaj më parë niveli i depozitave pësoi rënie prej rreth 4.410 milionë lekë, ndërsa krahasuar me një vit më parë totali i depozitave ka shënuar rritje me 25.872 milionë lekë.


# Sektori Fiskal

## 1. Buxheti i Konsoliduar

Për periudhën Janar-Maj 2019 janë mbledhur rreth 188.464 miliardë lekë të ardhura, përkundrejt shpenzimeve të përgjithshme prej 188.063 miliardë lekë, ku pjesa më e madhe përfshin 165.834 miliardë lekë në shpenzime korrente dhe rreth 22.198 miliardë lekë në shpenzime kapitale, nga të cilat rreth 26.8% janë financime të huaja.

Nga të ardhurat gjithsej, pjesa e të ardhurave të mbledhura nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Doganave është rreth 124.713 miliardë lekë (ose rreth 98% e planit të periudhës). Të ardhurat e mbledhura nga pushteti vendor rreth 11.348 miliardë lekë (ose rreth 124% e planit të periudhës). Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore 40.375 miliardë lekë (ose rreth 100% e planit të periudhës) dhe të ardhurat jokatimore në nivelin 10.191 miliardë lekë (ose rreth 105% e planit për periudhën Janar-Maj 2019).

Nga totali i shpenzimeve korrente prej 165.834 miliardë lekë, 31.065 miliardë lekë (18.7% e totalit të shpenzimeve korrente) është shpenzuar për personelin, rreth 14.126 miliardë



lekë (8.5%) për shpenzime interesi, 18.123 miliardë leke (10.9%) për shpenzime operative dhe mirëmbajtje, 489 milionë lekë (0.3%) për subvencione, 66.952 miliardë lekë (40.4%) për shpenzimet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, 24.071 miliardë lekë (14.5%) për shpenzimet e qeverisjes vendore, dhe 9.896 miliardë lekë (6%) për shpenzimet e tjera. Këto përfaqësojnë 38% (shpenzime personeli), 34% (shpenzime për interesat), 39% (shpenzime operative dhe të mirëmbajtjes), 33% (subvencione), 39% (sigurimet shoqërore dhe shëndetësore), 47% (për shpenzimet e qeverisjes vendore) dhe 41% (shpenzimet e tjera) përkundrejt planifikimit të tyre vjetor.

Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm për këtë periudhë ishin 28%, ndërsa financimi i huaj është 18% e planifikimit të tyre vjetor.

## 2. Të ardhurat sipas burimeve

Të ardhurat gjithsej të realizuara për periudhën Janar-Maj 2019 ishin rreth 188.464 miliardë lekë, nga të cilat të ardhurat tatimore rreth 176.918 miliardë lekë, të ardhurat jo-tatimore në rreth 10.191 miliardë lekë.

Tab - 2	Të ardhurat gjatë muajit Maj 2019 (mld Lekë) Revenues during May 2019 (in billion ALL)			
	Burimi (Source)	Maj '19 May '19	Maj '18 May '18	Ndrysh(%) Chang (%)
	TVSH (VAT)	11.4	12.4	-4.7
	Taksa doganore (Custom Tax)	0.59	0.56	5.0
	Akcizat (Excise)	3.75	3.70	1.3
	Tatimi mbi fitimin (Profit Tax)	2.42	2.53	-4.4
	Tatim mbi të ardhurat personale (TAP) / (Income Tax)	5.78	2.80	106.2
	Taksat nacionale (National Tax)	2.67	2.96	-9.9

Burimi: Ministria e Financave, Statistikat Fiskale: Maj – 2019

Source: Ministry of Finance, Fiscal Statistics: May – 2019

## 3. Financimi i Bilancit Fiskal

Suficiti prej 0.4 miliardë lekë gjatë periudhës Janar-Maj 2019, u përdor kryesisht për huamarrjen e brendshme, si mjeti kryesor i financimit të brendshëm dhe për huanë afatgjatë të huaj.

Për muajin Maj 2019, disa nga treguesit kryesor fiskalë ishin:

- Realizimi i të ardhurave në masën 39.173 miliardë lekë,

- Realizimi i shpenzimeve në masën 41.796 miliardë lekë.

Në realizimin e të ardhurave për muajin Maj 2019, kontributin kryesor e kanë dhënë të ardhurat tatimore, të cilat arrijnë shifrën e 36.5 miliardë lekë. Në realizimin e shpenzimeve për këtë muaj, peshën me të lartë e zënë shpenzimet korrente me 35.8 miliardë lekë dhe shpenzimet kapitale me rreth 5.9 miliardë lekë.

# Aneksi Statistikor

Tab - 1

Muaji	Mujor (Monthly)					Mesatar Mujor (Monthly Average)					Vjetor (Annual)					Month
	2015	2016	2017	2018	2019	2015	2016	2017	2018	2019	2015	2016	2017	2018	2019	
Janar	1.4	0.9	1.5	1.5	1.6	1.4	0.9	1.5	1.5	1.6	1.3	1.5	2.8	1.7	1.9	January
Shkurt	2.4	1.1	0.5	0.8	0.6	1.9	1.0	1.0	1.0	1.1	2.3	0.2	2.2	2.1	1.7	February
Mars	0.4	0.5	0.4	0.3	-0.3	1.4	0.8	0.8	0.9	0.6	2.2	0.3	2.1	2.0	1.1	March
Prill	-0.5	-0.4	-0.6	-0.5	-0.2	0.9	0.5	0.5	0.5	0.4	2.3	0.3	1.9	2.1	1.4	April
<b>Maj</b>	-1.6	-1.2	-1.2	-1.2	<b>-1.0</b>	0.2	0.2	0.1	0.2	<b>0.1</b>	1.8	0.7	2.0	2.1	<b>1.5</b>	<b>May</b>
Qershor	-1.1	-0.6	-0.4	-0.1		0.1	0.04	0.0	0.1		1.4	1.2	2.2	2.4		June
Korrik	-0.7	0.0	-0.1	-0.3		0.1	0.17	0.0	0.1		1.3	1.9	2.0	2.3		July
Gusht	0.8	0.9	0.4	0.4		0.1	0.19	0.1	0.1		1.9	2.0	1.6	2.2		August
Shtator	0.6	0.4	0.4	0.2		0.2	0.17	0.1	0.1		2.2	1.8	1.6	2.1		September
Tetor	0.0	-0.2	0.0	-0.2		0.1	0.13	0.1	0.1		2.1	1.5	1.9	1.9		October
Nëntor	-0.3	0.1	-0.1	-0.2		0.1	0.12	0.1	0.1		2.1	1.9	1.7	1.8		November
Dhjetor	0.6	0.9	1.0	1.1		0.17	0.19	0.2	0.2		2.0	2.2	1.8	1.8		December

Burimi: INSTAT

Source : INSTAT

Tab - 2

## Kursi i këmbimit

Exchange rate

Monedha	2015	2016	2017	2018	2019					Currency
					Janar	Shkurt	Mars	Prill	<b>Maj</b>	
					January	February	March	April	<b>May</b>	
<i>Mesatarja e periudhës</i>										<i>Average of period</i>
USD	126.64	128.29	112.56	108.43	108.92	109.73	110.53	110.57	109.96	USD
EURO	137.65	135.27	133.25	123.45	124.39	124.56	124.99	124.34	122.99	EURO
<i>Fundi i periudhës</i>										<i>In the end of period</i>
USD	125.79	128.17	111.10	107.82	108.58	110.51	111.67	110.09	109.97	USD
EURO	137.28	135.23	132.95	123.42	124.64	125.92	125.34	123.38	122.63	EURO

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

Tab - 3

## Normat e interesit me bazë vjetore (në Lek)

Annual Interest Rates (in ALL)

Në përqindje	2015	2016	2017	2018	2019					In percent
					Janar January	Shkurt February	Mars March	Prill April	Maj May	
<b>Norma e depozitave</b>										Deposits rates
12-M	1.27	0.78	0.80	0.75	0.73	0.68	0.57	0.48	0.43	12-M
6-M	1.17	0.78	0.56	0.56	0.45	0.45	0.56	0.52	0.42	6-M
3-M	0.54	0.27	0.29	0.30	0.24	0.25	0.31	0.18	0.19	3-M
1-M	0.88	0.87	0.82	0.62	0.65	0.71	0.55	0.62	0.53	1-M
<b>Norma e huasë</b>										Lending rates
12-M	7.47	4.54	6.79	6.34	6.76	5.89	5.89	6.23	6.55	12-M
6-M	8.35	7.01	8.12	8.16	7.63	7.50	7.69	6.87	9.67	6-M
<b>Norma e letrave me vlerë</b>										Securities rates
Bono thesari 1/										Treasury bills 1/
3-M	-	-	-	-	-	-	-	-	-	3-M
6-M	2.46	2.00	-	-	-	1.07	-	0.85	0.96	6-M
12-M	2.40	2.92	2.63	1.43	1.33	1.25	1.14	1.11	1.29	12-M

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania



## TREGUESIT FISKAL SIPAS BUXHETIT TË KONSOLIDUAR 2019

Fiscal indicators regarding consolidated budget of 2019

Të dhëna progresive (Progressive Data)

në milionë Lekë (in million ALL)

Nr.	E M Ë R T I M I	Janar January	Shkurt February	Mars March	Prill April	Maj May	ITEMS
	<b>TOTALI TË ARDHURAVE</b>	<b>34,675</b>	<b>68,862</b>	<b>108,222</b>	<b>149,290</b>	<b>188,464</b>	<b>TOTAL REVENUE</b>
I.	<b>Të ardhura nga ndihmat</b>	<b>251</b>	<b>461</b>	<b>656</b>	<b>1,011</b>	<b>1,227</b>	<b>Grants</b>
II.	<b>Të ardhura tatimore</b>	<b>33,030</b>	<b>64,590</b>	<b>101,552</b>	<b>140,451</b>	<b>176,918</b>	<b>Tax Revenue</b>
II.1	<b>Nga Tatimet dhe Doganat</b>	<b>22,638</b>	<b>44,928</b>	<b>72,773</b>	<b>97,755</b>	<b>124,713</b>	<b>From tax offices and customs</b>
1	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar	10,971	21,550	32,380	43,518	54,961	V.A. T
2	Tatimi mbi Fitimin	1,613	4,049	11,651	15,272	17,696	Profit Tax
3	Akcizat	2,900	6,025	9,863	13,230	16,982	Excise Tax
4	Tatimi mbi të Ardhurat Personale	3,677	6,593	9,376	12,651	18,440	Personal Income Tax
5	Taksa Nacionale dhe të tjera	3,068	5,871	8,092	11,118	14,076	National Taxes and others
6	Taksa Doganore	410	840	1,411	1,966	2,558	Customs Duties
II.2	<b>Të ardhura nga Pushteti Vendor</b>	<b>1,353</b>	<b>3,173</b>	<b>4,909</b>	<b>9,627</b>	<b>11,348</b>	<b>Revenues from Local Gov.</b>
1	Taksë mbi Pasurinë (ndërtesat)	221	431	817	2,279	2,665	Property Tax
2	Taksë mbi Biznesin e vogël	1	5	27	252	282	Small Business Tax
3	Taksa Lokale	1,131	2,737	4,066	7,096	8,401	Local Taxes
II.3	<b>Të ardh nga fondet speciale</b>	<b>9,038</b>	<b>16,488</b>	<b>23,870</b>	<b>33,069</b>	<b>40,856</b>	<b>Social ins. contributions</b>
1	Sigurimi Shoqëror	7,711	14,067	20,421	28,194	34,918	Social Insurance
2	Sigurimi Shëndetsor	1,271	2,213	3,167	4,454	5,456	Health insurance
III.	<b>Të ardhura Jotatimore</b>	<b>1,258</b>	<b>3,674</b>	<b>5,876</b>	<b>7,692</b>	<b>10,191</b>	<b>Nontax Revenue</b>
1	Tran.Fitimi nga Banka e Shqipërisë			576	576	576	Profit transfer from BOA
2	Të ardhura nga Inst.Buxhetore	712	2,622	3,842	5,091	6,823	Income of budgetary institutions
	<b>TOTALI I SHPENZIMEVE</b>	<b>32,445</b>	<b>67,578</b>	<b>104,591</b>	<b>146,268</b>	<b>188,063</b>	<b>TOTAL EXPENDITURE</b>
I.	<b>Shpenzime Korrente</b>	<b>28,971</b>	<b>61,789</b>	<b>95,344</b>	<b>129,973</b>	<b>165,834</b>	<b>Current Expenditures</b>
I.1	<b>Personeli</b>	<b>5,949</b>	<b>12,034</b>	<b>18,305</b>	<b>24,484</b>	<b>31,065</b>	<b>Personnel expenditures</b>
1	Paga	5,100	10,315	15,679	20,991	26,629	Wages
2	Kontributi për Sigurime Shoqërore	844	1,693	2,570	3,419	4,337	Social insurance contributions
I.2	<b>Interesat</b>	<b>4,047</b>	<b>6,750</b>	<b>9,525</b>	<b>12,029</b>	<b>14,126</b>	<b>Interest</b>
1	Të Brendshme	2,846	4,922	6,977	8,836	10,442	Domestic
2	Të Huaja	1,200	1,828	2,547	3,193	3,685	Foreign
I.3	<b>Shpenzime Operative Mirëmbajtje</b>	<b>2,487</b>	<b>5,478</b>	<b>9,028</b>	<b>13,835</b>	<b>18,123</b>	<b>Operational &amp; Maintenance</b>
I.4	<b>Subvencionet</b>	<b>74</b>	<b>203</b>	<b>359</b>	<b>430</b>	<b>489</b>	<b>Subsidies</b>
I.5	<b>Shpenzime për fonde speciale</b>	<b>12,387</b>	<b>25,873</b>	<b>40,017</b>	<b>53,663</b>	<b>68,063</b>	<b>Social insurance outlays</b>
1	Sigurime Shoqërore	9,547	19,193	29,265	39,652	50,440	Social insurance
2	Sigurime Shëndetsore	2,376	5,890	9,963	13,097	16,512	Health insurance
I.6	<b>Shpenzime per Buxhetin Vendor</b>	<b>2,701</b>	<b>8,097</b>	<b>12,669</b>	<b>17,966</b>	<b>24,071</b>	<b>Local budget expenditure</b>
I.7	<b>Shpenzime të tjera</b>	<b>1,327</b>	<b>3,354</b>	<b>5,441</b>	<b>7,566</b>	<b>9,896</b>	<b>Other expenditures</b>
1	Pagesa e Papunesisë	33	76	130	180	225	Unemployment insurance benefits
I.8	<b>Transferime Kapitale</b>				35	37	
II	<b>Fondi Rezerve, Kontigjenca</b>						<b>Reserve fund/contingency</b>
III	<b>Shpenzime Kapitale</b>	<b>3,474</b>	<b>5,782</b>	<b>9,241</b>	<b>16,253</b>	<b>22,198</b>	<b>Capital expenditures</b>
1	Financimi Brendshëm	2,583	3,237	6,027	11,250	15,950	Domestically financing
2	Financimi Huaj	886	2,496	3,145	4,847	5,949	Foreign financed
IV	<b>Detyrimet e prapambetuara</b>						<b>Arrears</b>
V.	<b>DEFICITI</b>	<b>2,230</b>	<b>1,284</b>	<b>3,630</b>	<b>3,023</b>	<b>400</b>	<b>CASH BALANCE</b>
V.1	<b>FINANCIMI DEFICITIT</b>	<b>-2,230</b>	<b>-1,284</b>	<b>-3,630</b>	<b>-3,023</b>	<b>-400</b>	<b>CASH BALANCE FINANCING</b>
V.2	<b>Brendshëm</b>	<b>-1,502</b>	<b>-2,473</b>	<b>-3,348</b>	<b>1,828</b>	<b>4,534</b>	<b>Domestic</b>
1	Të ardhura nga privatizimi	29	34	47	67	76	Privatization receipts
2	Hua-marrje e brendshme	-5,900	-7,329	-2,600	799	2,733	Domestic new borrowing (net)
3	Të tjera	4,369	4,823	-795	961	1,726	Others
V.3	<b>I huaj</b>	<b>-728</b>	<b>1,189</b>	<b>-283</b>	<b>-4,850</b>	<b>-4,935</b>	<b>Foreign</b>
1	Hua afatgjatë(e marrë)	1,403	2,488	2,919	4,268	6,385	Long-term foreign borrowing (gross)
	Nga e cila nënhua	222	291	447	491	979	Subsidiary Loan
2	Ndryshimi i gjendjes së arkës*	-804	-445	-250	-206	-982	Chang. of stat. Account
3	Ripagesat	-1,327	-2,254	-4,352	-10,313	-11,737	Repayments
4	Mbështetje Buxhetore	-	1,400	1,400	1,400	1,400	Budgetary Support

Tab - 5

**Tabela e investimeve 2019**

Table of investments 2019

*Të dhëna progresive (Progressive Data)*

*në milionë Lekë ( in million ALL)*

	Janar January	Shkurt February	Mars March	Prill April	Maj May	
<b>Financim i brendshëm</b>	- 1,502	- 2,473	- 3,348	1,828	4,534	<b>Domestic financing</b>
<i>Në %</i>	67.4	192.59	92.2	-60.46	-1133.56	<i>In %</i>
<b>Financim i huaj</b>	- 728	1,189	- 283	- 4,850	- 4,935	<b>Foreign financing</b>
<i>Në %</i>	32.6	-92.59	7.8	160.46	1233.56	<i>In %</i>
<b>Totali</b>	<b>-2,230</b>	<b>-1,284</b>	<b>-3,630</b>	<b>-3,023</b>	<b>-400</b>	<b>Total</b>
<i>Në %</i>	100	100	100	100	100	<i>In %</i>

Burimi: Ministria e Financave

Source: Ministry of Finance

**Tab - 6 TË ARDHURAT DOGANORE 2019  
CUSTOMS REVENUES 2019**

*Të dhëna progresive (Progressive Data)*

*në milionë Lekë ( in million Lek)*

	Janar January	Shkurt February	Mars March	Prill April	Maj May	
Taksë doganore	410	840	1,411	1,966	2,558	Customs Duties
TVSH	6,893	14,742	23,426	32,766	42,243	V.A.T
Akcizë	2,900	6,025	9,862	13,229	16,982	Excises
Të tjera (Renta Minerare)	201	356	532	731	1,017	Others (Mineral Rent)
<b>TOTALI</b>	<b>10,403</b>	<b>21,963</b>	<b>35,231</b>	<b>48,692</b>	<b>62,800</b>	<b>Total</b>

**TË ARDHURAT TATIMORE 2019 (TAX REVENUE )**

TVSH	4,079	6,808	8,954	10,751	12,718	V.A.T
Tatim mbi fitimin	1,613	4,049	11,651	15,272	17,696	Profit Tax
Tatimi mbi të ardhurat personale	3,677	6,593	9,376	12,651	18,440	Personal income tax
Taksa nacionale dhe të tjera	2,867	5,515	7,560	10,387	13,059	National taxes
<b>TOTALI</b>	<b>12,235</b>	<b>22,965</b>	<b>37,541</b>	<b>49,062</b>	<b>61,913</b>	<b>Total</b>
<b>TOTALI I PËRGJITHSHËM</b>	<b>22,638</b>	<b>44,928</b>	<b>72,772</b>	<b>97,754</b>	<b>124,713</b>	<b>OVERALL TOTAL</b>

Burimi: Ministria e Financave

Source: Ministry of Finance

## DEFICITI DHE FINANCIIMI PËR 2019

The Deficit and Its Financing for 2019

Të dhëna progresive (Progressive Data)

Në milionë lekë (In million Leks)

	Janar January	Shkurt February	Mars March	Prill April	Maj May	
<b>TË ARDHURAT</b>	<b>34,675</b>	<b>68,862</b>	<b>108,222</b>	<b>149,290</b>	<b>188,464</b>	<b>REVENUE</b>
<b>SHPENZIMET</b>	<b>32,445</b>	<b>67,578</b>	<b>104,591</b>	<b>146,268</b>	<b>188,063</b>	<b>EXPENDITURES</b>
<b>BILANCI FISKAL</b>	<b>2,230</b>	<b>1,284</b>	<b>3,630</b>	<b>3,023</b>	<b>400</b>	<b>FISCAL BALANCE</b>
<b>FINANCIIMI I BILANCIT FISKAL</b>	<b>-2,230</b>	<b>-1,284</b>	<b>-3,630</b>	<b>-3,023</b>	<b>-400</b>	<b>FINANCING</b>
<b>Financimi i brendshëm</b>	<b>-1,502</b>	<b>-2,473</b>	<b>-3,348</b>	<b>1,828</b>	<b>4,534</b>	<b>Domestic</b>
a. Bono Thesari Neto	-1,799	-2,038	-2,192	-3,413	-1,297	Treasury bills
b. Obligacione	-4,088	-5,266	-368	4,265	4,090	Bonds
c. <i>Ndryshimi i gjëndjes së arkës</i>	13,883	14,151	12,003	11,117	10,836	Chang.of stat. account
Depozita e qeverisë në BSH	13,689	13,285	11,926	10,666	10,355	Deposit of Government in B.O.A
Depozita e ISSH dhe ISKSH	193	866	77	451	481	Deposit of Social & Health Ins.
d.Mjete në ruajtje	413	341	501	743	804	Non-budget revenues
e.Të ardhura nga privatizimi	29	34	47	67	76	Privatization receipts
f.Të tjera detyrime	-9,926	-9,668	-13,298	-10,899	-9,914	Others
g.Huamarrje Brendshme Vendori	-14	-25	-40	-53	-60	Local Borrowing
<b>Financimi i jashtëm</b>	<b>-728</b>	<b>1,189</b>	<b>-283</b>	<b>-4,850</b>	<b>-4,935</b>	<b>Foreing</b>
a. Hua afatgjatë	1,403	2,488	2,919	4,268	6,385	Long-term foreign borrowing (gross)
b. Ndryshimi I gjëndjes së arkës	-804	-445	-250	-206	-982	Chang. of stat. Account
c.Ripagesat	-1,327	-2,254	-4,352	-10,313	-11,737	Repayments
d.Mbeshetjet Buxhetore	0	1,400	1,400	1,400	1,400	Budgetary Support

Burimi: Ministria e Financave

Source: Ministry of Finance

**BILANCI I PAGESAVE**

Balance of payments

Në milion Euro

In millions Euro

	Viti 2013	Viti 2014	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018	3M_I_2019	
<b>Llogaria korente</b>	<b>-1,026.70</b>	<b>-1,303.20</b>	<b>-1,160.50</b>	<b>-811.60</b>	<b>-865.60</b>	<b>-859.70</b>	<b>-243.30</b>	<b>Current Account.</b>
<b>Bilanci tregtar</b>	<b>-1,729.30</b>	<b>-2,136.60</b>	<b>-2,298.80</b>	<b>-2,602.80</b>	<b>-2,824.10</b>	<b>-2,871.00</b>	<b>-694.40</b>	<b>Trade Balance.</b>
Eksporti I mallrave fob	1,731.50	925.30	771.10	713.70	797.10	986.10	209.50	Merchandise Exports. Fob
Importi I mallrave fob	-3,460.80	-3,061.90	-3,069.90	-3,316.50	-3,621.20	-3,857.10	-903.90	Merchandise Imports. Fob
<b>Bilanci i shërbimeve</b>	<b>8.90</b>	<b>268.40</b>	<b>502.80</b>	<b>796.60</b>	<b>1,081.90</b>	<b>1,104.00</b>	<b>288.80</b>	<b>Services Balance.</b>
Shërbimet Kredi	1,655.00	2,031.50	2,028.20	2,395.70	2,856.20	3,065.80	674.30	Services Credit
Shërbimet Debi	-1,646.10	1,763.10	1,503.30	1,599.10	1,774.30	1,961.80	385.50	Services Debt
<b>Bilanci i të ardhurave</b>	<b>-8.40</b>	<b>-159.60</b>	<b>-133.00</b>	<b>174.10</b>	<b>28.90</b>	<b>-5.40</b>	<b>-28.90</b>	<b>Balance of Incomes</b>
Të ardhurat Kredi	193.30	110.60	126.00	408.70	407.70	398.00	80.20	Income Credit
Të ardhurat Debi	-201.70	-270.20	-259.00	-234.60	-378.80	-403.40	-109.10	Income Debt
<b>Bilanci i transfertave</b>	<b>702.10</b>	<b>724.60</b>	<b>768.50</b>	<b>820.50</b>	<b>847.70</b>	<b>912.70</b>	<b>191.20</b>	<b>Balance of Transfers</b>
Transferta private	681.40	851.80	921.50	961.20	961.80	1,002.90	219.20	Private Unrequired Transfers
Transferrat shtetërore	20.70	-127.20	-153.00	-140.70	-114.10	-90.20	-28.00	Official Unrequired Transfers
<b>Llogaria kapitale</b>	<b>47.70</b>	<b>86.70</b>	<b>125.70</b>	<b>66.20</b>	<b>122.30</b>	<b>104.00</b>	<b>17.50</b>	<b>Capital Account</b>
<b>Llogaria financiare</b>	<b>775.60</b>	<b>-956.30</b>	<b>-1,326.20</b>	<b>-664.30</b>	<b>-1,115.30</b>	<b>-1,145.30</b>	<b>-288.50</b>	<b>Financial Account</b>
Investime direkte	893.10	-801.30	-823.00	-936.50	-993.80	-1,026.00	-279.40	Direct Investment
Investime portofoli	-103.70	120.80	-324.80	225.20	-100.00	-75.10	-0.10	Portfolio Investment
Kapitale të tjera	-13.80	-275.80	-88.50	187.40	49.00	-50.30	-9.30	Other Capital
<b>Gabime dhe harresa neto</b>	<b>315.30</b>	<b>311.00</b>	<b>296.00</b>	<b>128.90</b>	<b>-186.30</b>	<b>-18.20</b>	<b>-133.50</b>	<b>Net errors and omissions</b>
<b>Bilanci i përgjithshëm</b>	<b>111.90</b>	<b>50.80</b>	<b>259.50</b>	<b>47.80</b>	<b>185.70</b>	<b>371.40</b>	<b>-70.80</b>	<b>Overall Balance</b>
		<b>0.00</b>	<b>0.00</b>					
Rezervat	-104.40	97.20	609.60	47.70	185.40	371.50	-70.70	Reserve Assets
Përdor kred & huash nga FMN	-7.80	46.40	89.90	140.40	70.50	-6.10	-0.30	Use of Fund Credit and Loans

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

**MJETET VALUTORE NETO**

Net Foreign Assets

Në milionë Lekë Fundi i periudhes	2015	2016	2017	2018	2019					Millions of Lek End of Period
					Janar January	Shkurt February	Mars March	Prill April	Maj May	
Mjetet valutore neto	365,663.3	389,612.7	390,687.6	412,444.5	404,157.2	406,573.1	412,974.7	394,586.1	395,523.1	Net Foreign assets
Pretendime ndaj jorezidentëve	407,654.7	418,562.1	417,605.4	436,487.8	428,969.2	431,419.9	437,560.5	419,740.9	421,134.8	Claims on non-residents
Minus: Detyrime ndaj jorezidentëve	41,991.5	28,949.4	26,917.8	24,043.3	24,812.0	24,846.7	24,585.7	25,154.8	25,611.7	Minus: Liabilities to non-residents
Mjetet e brendshme	63,394	65,915.7	59,998	21,779	24,331	23,987	28,805	30,047	31,223	Domestic Assets
Pretendimet neto ndaj qeverisë qendrore	48,752	34,255.6	18,407	-12,366	277	4,001	4,820	2,883	2,117	Claims on Central Government
Pretendimet ndaj qeverisë qendrore	75,143.9	53,279.9	52,839.5	55,628.9	56,113.1	55,325.8	56,343.6	56,163.1	55,510.5	Net Calims on Central Government
Minus: Detyrime ndaj qeverisë qendrore	26,391.9	19,024.3	34,432.8	67,994.8	55,836.4	51,324.7	51,523.7	53,280.4	53,393.4	Minus: Due to Central Government
Pretendime ndaj korporatave të tjera depozituese	12,237.0	29,934.4	39,871.3	32,317.6	22,207.0	18,107.7	22,044.2	25,181.2	27,082.1	Claims on other depository corporations
Pretendime ndaj korporatave të tjera financiare	-	-	-	-	-	-	-	-	-	Claims on other financial corporations
Pretendime ndaj korporatave jofinanciare publike	-	-	-	-	-	-	-	-	-	Claims on public non-financial corporations
Pretendime ndaj korporatave të tjera jofinanciare	-	-	-	-	-	-	-	-	-	Claims on other non-financial corporations
Pretendime ndaj sektorëve të tjerë rezidentë	1,648.9	1,725.7	1,720.0	1,827.2	1,847.0	1,878.3	1,940.4	1,982.9	2,023.5	Claims on other resident sectors
Baza Monetare	383,972.8	414,380.9	452,243.1	423,427.9	413,895.1	412,381.9	423,488.7	411,205.9	414,282.4	Monetary Baze
Depozita të papërfshira në parinë e gjerë	451.8	194.0	146.6	80.6	81.3	85.2	85.7	80.8	80.3	Deposits not included in broad money
Huatë	-	-	-	-	-	-	-	-	-	Loans
Llogari të pagueshme	34.2	47.2	96.8	285.4	246.0	96.1	110.1	183.2	48.1	Other accounts payable
Të tjera neto	-18,792	-20,953.6	-20,683	-20,659	-20,670	-20,836	-20,839	-20,830	-20,796	Other items net
Aksione	63,391.1	61,859.9	45,882.2	31,088.6	34,935.9	38,832.9	38,933.6	33,992.8	33,131.4	Shares and other equity

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

Tab - 10 **KREDIA PËR EKONOMINË**  
Credit to Economy

Në milion Lekë Fundi i periudhës	2015	2016	2017	2018	2019					Million of Lek End of Period
					Janar January	Shkurt February	Mars March	Prill April	Maj May	
<b>Totali i kredisë</b>	<b>546,873</b>	<b>547,602.4</b>	<b>550,280.4</b>	<b>532,628.2</b>	<b>536,695.9</b>	<b>541,549.5</b>	<b>547,343.2</b>	<b>545,775.0</b>	<b>548,922.2</b>	<b>Total Credit</b>
<b>Kredia për qeverinë lokale</b>	<b>887.7</b>	<b>845.5</b>	<b>787.7</b>	<b>539.0</b>	<b>677.1</b>	<b>662.6</b>	<b>656.7</b>	<b>638.3</b>	<b>632.9</b>	<b>Credits to local Government</b>
Në lekë	887.7	845.5	787.7	539.0	677.1	662.6	656.7	638.3	632.9	in Lek
Në valutë	-	-	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	in Foreign Currency
<b>Kredia për korporatat jofinanciare publike</b>	<b>27,419.7</b>	<b>26,863.9</b>	<b>29,515.4</b>	<b>20,270.1</b>	<b>20,810.7</b>	<b>19,834.9</b>	<b>21,416.8</b>	<b>20,993.0</b>	<b>21,207.8</b>	<b>Credits to Public Non-financial Corporations</b>
Në Lekë	22,326.1	23,993.9	24,453.5	16,594.2	16,799.0	15,785.0	16,830.4	16,439.4	16,733.8	in Lek
Në valutë	5,093.6	2,870.0	5,061.9	3,675.9	4,011.7	4,049.9	4,586.4	4,553.6	4,474.0	in Foreign Currency
<b>Kredia për korporatat jofinanciare private</b>	<b>355,725.2</b>	<b>343,483.0</b>	<b>334,762.9</b>	<b>317,722.0</b>	<b>320,223.3</b>	<b>324,487.5</b>	<b>326,947.9</b>	<b>326,014.50</b>	<b>327,208.2</b>	<b>Credits to other Non-financial Corporations</b>
Në Lekë	129,233.7	131,743.5	136,075.7	127,999.7	127,162.2	127,938.4	129,000.0	129,532.10	128,820.00	in Lek
Në valutë	226,491.5	211,739.5	198,687.2	189,722.3	193,061.1	196,549.1	197,947.9	196,482.40	198,388.20	in Foreign Currency
<b>Kredia për korporatat e tjera financiare</b>	<b>9,537.7</b>	<b>8,687.6</b>	<b>7,944.6</b>	<b>10,164.0</b>	<b>10,234</b>	<b>10,433</b>	<b>11,102</b>	<b>11,039</b>	<b>11,618</b>	<b>Credits to Other Financial Corporations</b>
Në Lekë	5,036.2	4,242.3	3,522.3	4,802.1	4,738	4,893	5,418	5,610	6,145	in Lek
Në valute	4,501.5	4,445.3	4,422.3	5,361.9	5,495.9	5,539.9	5,684.0	5,428.3	5,472.3	in Foreign Currency
<b>Pretendime për sektorë të tjerë rezidentë</b>	<b>153,303.1</b>	<b>167,722.4</b>	<b>177,269.8</b>	<b>183,933.1</b>	<b>184,750.5</b>	<b>186,131.9</b>	<b>187,219.6</b>	<b>187,090.7</b>	<b>188,255.8</b>	<b>Claims to other Resident Sectors</b>
Në Lekë	83,319.7	98,722.3	108,419.1	118,744.1	119,297.6	119,772.1	121,019.2	121,927.5	123,296.1	in Lek
Në valutë	69,983.4	69,000.1	68,850.7	65,189.0	65,452.9	66,359.8	66,200.4	65,163.2	64,959.7	in Foreign Currency

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

Tab - 11 **OFERTA E PARASË**  
Money Supply

Mujor-Monthly

Në milion Lekë Fundi i periudhës	2015	2016	2017	2018	2019					Millions of LEK End of Period
					Janar January	Shkurt February	Mars March	Prill April	Maj May	
<b>Baza monetare</b>	<b>383,972.8</b>	<b>414,380.9</b>	<b>425,243.1</b>	<b>423,427.9</b>	<b>413,895.1</b>	<b>412,381.9</b>	<b>423,488.7</b>	<b>411,205.9</b>	<b>414,282.4</b>	<b>Base Money</b>
Ndryshimi vjetor në %	15.3	7.9	2.6	-0.4	2.7	3.3	7.9	1.1	1.1	Y/Y change in %
<b>Paraja jashtë korporatave depozituese</b>	<b>239,218.1</b>	<b>249,256.5</b>	<b>265,156.0</b>	<b>275,281.4</b>	<b>271,542.9</b>	<b>272,762.3</b>	<b>274,731.9</b>	<b>273,146.2</b>	<b>274,191.0</b>	<b>Currency Outside Depository</b>
Ndryshimi vjetor në %	9.9	4.2	6.4	3.8	5.5	5.9	8.0	8.1	7.6	Y/Y change in %
<b>Depozita</b>	<b>687,292.6</b>	<b>737,808</b>	<b>741,157</b>	<b>745,304</b>	<b>755,851.1</b>	<b>756,964.1</b>	<b>755,099.9</b>	<b>755,297.3</b>	<b>753,055.5</b>	<b>Deposits</b>
Ndryshimi vjetor në %	-29.7	7.3	0.5	0.6	2.0	2.7	3.7	3.9	4.3	Y/Y change in %
<b>Agregati M1</b>	<b>384,106.9</b>	<b>435,432.3</b>	<b>461,550.1</b>	<b>478,717.6</b>	<b>481,254.7</b>	<b>483,695.2</b>	<b>487,483.1</b>	<b>485,576.6</b>	<b>487,749.6</b>	<b>M1 Aggregate</b>
Ndryshimi vjetor në %	8.7	13.4	6.0	3.7	6.5	6.6	9.9	9.1	9.0	Y/Y change in %
<b>Agregati M2</b>	<b>723,975.7</b>	<b>736,944.1</b>	<b>738,900.0</b>	<b>731,352.3</b>	<b>732,038.2</b>	<b>733,256.7</b>	<b>735,846.3</b>	<b>732,066.0</b>	<b>733,653.4</b>	<b>M2 Aggregate</b>
Ndryshimi vjetor në %	0.2	1.9	0.3	-1.0	0.9	1.1	2.9	2.4	2.8	Y/Y change in %
<b>Agregati M3</b>	<b>1,218,101.2</b>	<b>1,263,453.8</b>	<b>1,266,906.9</b>	<b>1,263,928.1</b>	<b>1,274,889.0</b>	<b>1,278,601.6</b>	<b>1,277,962.4</b>	<b>1,271,731.6</b>	<b>1,268,366.4</b>	<b>M3 Aggregate</b>
Ndryshimi vjetor në %	1.9	3.9	0.3	-0.2	1.3	2.1	3.2	3.3	3.7	Y/Y change in %
<b>Burimet e bazës monetare</b>										<b>Monetary Base sources</b>
Mjetet e huaja neto	365,663.3	389,612.7	390,687.6	412,444.5	404,157.2	406,573.1	412,974.7	394,586.1	395,523.1	Net foreign assets
Mjetet e brendshme neto	63,394.2	65,915.7	59,998.0	21,779.0	24,330.7	23,987.1	28,804.5	30,046.7	31,222.8	Domestic assets
Pretendimet ndaj qeverisë qendrore neto	48,752.0	34,255.6	18,406.7	-12,365.8	276.7	4,001.1	4,819.9	2,882.7	2,117.1	Net Claims on central government
Pretendimet ndaj korporatave të tjera depozituese	12,987.1	29,934.4	39,871.3	32,317.6	22,207.0	18,107.7	22,044.2	25,181.2	27,082.1	Claims on other depository corporations

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania



Tab - 12 DEPOZITAT  
Deposits

Mujor-Monthly

Në milionë Lekë Fundi i periudhës	2015	2016	2017	2018	2019					Millions of Leks End of Period
					Janar January	Shkurt February	Mars March	Prill April	Maj May	
<b>Në lekë</b>	<b>493,374</b>	<b>487,687</b>	<b>473,744</b>	<b>456,071</b>	<b>460,495</b>	<b>460,495</b>	<b>461,115</b>	<b>458,920</b>	<b>459,463</b>	<b>In national currency</b>
<b>Depozitat e transfer + D. me likuiditet të lartë</b>	<b>153,506</b>	<b>186,176</b>	<b>196,394</b>	<b>203,436</b>	<b>209,712</b>	<b>210,933</b>	<b>212,751</b>	<b>212,431</b>	<b>213,559</b>	<b>Transferable deposits+Liquid deposits</b>
Qeveria lokale	1,473.8	1,907.5	1,344.4	1,482.1	1,294.7	1,200.9	1,476.8	1,412.0	1,305.0	Local governments
Korporata jofinanciare publike	8,736.2	6,786.0	8,656.7	8,861.1	9,710.2	9,420.3	10,020.0	9,225.3	9,878.0	Public non-financial corporations
Korporata të tjera financiare	1,258.9	2,071.0	2,524.8	2,586.8	3,014.7	4,205.9	2,986.3	2,996.0	2,994.8	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	40,993.6	46,051.0	48,979.3	49,221.4	53,372.8	51,109.0	50,917.1	50,672.4	49,640.9	Other non-financial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	101,043.0	129,360.4	134,889.0	141,284.9	142,319.5	144,996.9	147,351.0	148,124.8	149,739.9	Other resident sectors
<b>Depozita të tjera</b>	<b>339,869</b>	<b>301,512</b>	<b>277,350</b>	<b>252,635</b>	<b>250,783</b>	<b>249,562</b>	<b>248,363</b>	<b>246,489</b>	<b>245,904</b>	<b>Other deposits</b>
Qeveria lokale	29.9	18.9	15.2	13.1	12.8	12.9	12.9	12.9	10.0	Local governments
Korporata jofinanciare publike	815.0	976.8	705.2	1,634.7	1,707.0	1,709.3	1,641.2	1,641.2	1,741.0	Public non-financial corporations
Korporata të tjera financiare	3,573.4	7,553.4	9,282.1	5,050.5	4,126.7	3,937.3	3,903.6	3,834.7	4,125.8	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	11,292.1	6,502.2	9,062.4	9,687.0	9,171.0	9,030.8	8,529.0	8,145.7	8,361.1	Other non-financial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	324,158.3	286,460.2	258,285.1	236,249.4	235,765.9	234,871.3	234,276.6	232,854.9	231,666.1	Other resident sectors
<b>Në valutë</b>	<b>193,918</b>	<b>250,121</b>	<b>267,413</b>	<b>289,233</b>	<b>295,356</b>	<b>296,470</b>	<b>293,985</b>	<b>296,377</b>	<b>293,593</b>	<b>In foreign currency</b>
Qeveria lokale	209.5	366.1	139.8	113.4	147.7	179.2	111.2	134.1	157.2	Local governments
Korporata jofinanciare publike	3,645.4	2,999.4	2,086.3	1,407.7	1,711.8	1,696.6	1,951.2	1,932.2	2,042.8	Public non-financial corporations
Korporata të tjera financiare	2,641.2	1,815.4	3,756.9	3,616.6	3,561.2	3,872.6	3,389.4	4,776.7	4,300.9	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	53,618.9	73,325.0	74,187.3	78,055.3	81,182.5	78,009.9	74,801.6	78,221.9	77,036.7	Other non-financial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	133,803.4	171,614.8	187,242.7	206,039.8	208,752.6	212,711.2	213,732.0	211,312.5	210,055.3	Other resident sectors
<b>Totali</b>	<b>687,293</b>	<b>737,808</b>	<b>741,157</b>	<b>745,304</b>	<b>755,851</b>	<b>756,964</b>	<b>755,100</b>	<b>755,297</b>	<b>753,056</b>	<b>Total</b>
Qeveria lokale	1,713.2	2,292.5	1,499.4	1,608.6	1,455.2	1,393.0	1,600.9	1,559.0	1,472.2	Local governments
Korporata jofinanciare publike	13,196.6	10,762.2	11,448.2	11,903.5	13,129.0	12,826.2	13,612.4	12,798.7	13,661.8	Public non-financial corporations
Korporata të tjera financiare	7,473.5	11,439.8	15,563.8	11,253.9	10,702.6	12,015.8	10,279.3	11,607.4	11,421.5	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	105,904.6	125,878.2	132,229.0	136,963.7	143,726.3	138,149.7	134,247.7	137,040.0	135,038.7	Other non-financial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	559,004.7	587,435.4	580,416.8	583,574.1	586,838.0	592,579.4	595,359.6	592,292.2	591,461.3	Other resident sectors

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

Tab - 13 **BILANCI I PËRMBLEDHUR I BSH**  
Consolidated BoA Balance sheet

Në milion Lekë Fundi i periudhës	2015	2016	2017	2018	2019					Millions of Lek End of period
					Janar January	Shkurt February	Mars March	Prill April	Maj May	
<b>AKTIVET</b>	<b>516,358</b>	<b>524,731</b>	<b>532,927</b>	<b>547,104</b>	<b>529,941</b>	<b>527,659</b>	<b>538,818</b>	<b>523,989</b>	<b>526,638</b>	
<b>Total</b>	<b>126,386</b>	<b>131,887</b>	<b>187,367</b>	<b>209,596</b>	<b>197,631</b>	<b>196,817</b>	<b>196,257</b>	<b>182,805</b>	<b>199,475</b>	<b>Total</b>
Mbajtjet e SDR	30,578.8	27,211.8	25,725.3	19,625.0	20,028.7	20,136.8	20,082.1	19,429.1	19,164.2	SDR holdings
Arka në valutë	84.9	52.0	24.3	67.1	18.7	27.3	23.1	71.7	21.5	Foreign currency
Depozitat	95,722.4	104,622.9	161,617.3	189,904.2	177,584.0	176,652.6	176,151.8	163,303.7	180,289.4	Deposits
<b>Letrat me vlerë të ndryshme nga aksionet</b>	<b>323,679</b>	<b>315,113</b>	<b>259,538</b>	<b>261,577</b>	<b>266,052</b>	<b>268,535</b>	<b>276,166</b>	<b>271,030</b>	<b>254,848</b>	<b>Securities other than shares</b>
Jorezident	270,453.6	261,877.5	206,818.9	205,990.4	209,990.6	213,275.2	219,896.0	214,966.7	199,400.0	nonresidents
Qeveria qendrore	53,225.5	53,235.2	52,718.8	55,586.8	56,061.0	55,259.3	56,259.7	56,063.7	55,447.6	central government
<b>Huatë</b>	<b>14,641</b>	<b>31,660</b>	<b>41,591</b>	<b>34,145</b>	<b>24,054</b>	<b>19,985</b>	<b>23,983</b>	<b>27,162</b>	<b>29,103</b>	<b>Loans</b>
Qeveria qendrore	-	-	-	-	-	-	-	-	-	Central Government
Korporata të tjera depozituese	12,987.1	29,934.4	39,871.3	32,317.6	22,207.0	18,107.7	22,044.2	25,181.2	27,082.1	Other depository corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	1,654.0	1,725.9	1,719.8	1,827.1	1,846.5	1,876.8	1,938.4	1,981.1	2,020.8	Other resident secotrs
<b>Derivatet financiare</b>	<b>27.7</b>	<b>15.8</b>	<b>11.7</b>	<b>19.3</b>	<b>43.6</b>	<b>19.5</b>	<b>22.7</b>	<b>49.7</b>	<b>25.5</b>	<b>Financial derivatives</b>
<b>Llogari të arketueshme</b>	<b>32,741.6</b>	<b>25,094.1</b>	<b>23,844.9</b>	<b>21,224.9</b>	<b>21,648.6</b>	<b>21,649.0</b>	<b>21,744.8</b>	<b>22,304.0</b>	<b>22,579.0</b>	<b>Receivable accounts</b>
<b>Mjetet jofinanciare</b>	<b>18,882.5</b>	<b>20,961.2</b>	<b>20,574.7</b>	<b>20,542.0</b>	<b>20,512.4</b>	<b>20,654.7</b>	<b>20,655.4</b>	<b>20,637.8</b>	<b>20,607.8</b>	<b>Nonfinancial assets</b>
<b>DETYRIMET</b>	<b>516,358</b>	<b>524,731</b>	<b>532,927</b>	<b>547,104</b>	<b>529,941</b>	<b>527,659</b>	<b>538,818</b>	<b>523,989</b>	<b>526,638</b>	<b>LIABILITIES</b>
<b>Total</b>	<b>241,006</b>	<b>262,031</b>	<b>278,611</b>	<b>286,209</b>	<b>282,051</b>	<b>284,100</b>	<b>285,742</b>	<b>285,165</b>	<b>284,564</b>	<b>Total</b>
Para në qarkullim	239,218.1	258,848.0	274,711.8	286,158.4	281,990.3	282,878.3	285,643.3	284,907.8	284,503.0	Currency in Circulation
Depozitat e përfshira në paranë e gjerë	1,787.9	3,183.2	3,899.2	50.6	61.1	1,221.3	99.0	257.1	60.5	Deposits included in broad money
<b>Depozita të papërfshira në paranë e gjerë</b>	<b>201,586</b>	<b>191,380</b>	<b>200,514</b>	<b>222,292</b>	<b>204,765</b>	<b>196,705</b>	<b>206,357</b>	<b>196,710</b>	<b>200,517</b>	<b>Deposits excluded from broad money</b>
Jorezident	31,826.2	19,860.9	19,350.9	17,047.3	17,053.6	17,051.9	17,039.5	17,359.7	17,356.9	Nonresidents
Qeveria qendrore	26,340.8	18,975.1	34,384.3	67,945.2	55,786.6	51,285.7	51,485.8	53,228.4	53,360.6	Central government
Korporata të tjera depozituese	142,966.8	152,349.7	146,632.1	137,218.8	131,843.7	128,282.3	137,746.5	126,041.1	129,718.9	Other depository corporations
Korporata të tjera jofinanciare	87.4	72.1	66.7	49.6	50.3	54.2	54.6	54.1	53.8	Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	364.4	121.9	79.9	31.0	31.0	31.0	31.0	26.7	26.5	
<b>Huatë</b>	<b>1,810</b>	<b>314</b>	<b>116</b>	<b>18</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	-
Jorezidentët	1,809.6	314.2	115.6	18.3	0.1	0.0	-	-	-	Nonresidents
Qeveria qendrore	-	-	-	-	-	-	-	-	-	Central Government
Korporata të tjera depozituese	-	-	-	-	-	-	-	-	-	Other depository corporations
<b>Llogari të pagueshme</b>	<b>461.1</b>	<b>1,164.6</b>	<b>463.8</b>	<b>518.7</b>	<b>1,122.0</b>	<b>834.8</b>	<b>571.5</b>	<b>1,032.3</b>	<b>1,385.2</b>	<b>Other accounts payable</b>
<b>Alokimi i SDR</b>	<b>8,104.4</b>	<b>7,981.2</b>	<b>7,340.5</b>	<b>6,977.7</b>	<b>7,066.3</b>	<b>7,186.4</b>	<b>7,213.5</b>	<b>7,088.9</b>	<b>7,041.2</b>	<b>SDR allocation</b>
<b>Aksione dhe instrumenta të tjerë</b>	<b>63,391.1</b>	<b>61,859.9</b>	<b>45,882.2</b>	<b>31,088.6</b>	<b>34,935.9</b>	<b>38,832.9</b>	<b>38,933.6</b>	<b>33,992.8</b>	<b>33,131.4</b>	<b>Shares and other equity</b>

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania